



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, 21 dhjetor 2023
Nr. ref.:RK 2309/23

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI94/23

Parashtrues

Rexhep Ajvazi

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit [AC-I-21-0844] të Kolegjit të
Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës të 26 janarit
2023**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar dhe
Enver Peci, gjyqtar

Parashtruesi e kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Rexhep Ajvazi (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës) me vendbanim në fshatin Gadish, komuna e Gjilanit dhe përfaqësohet nga Shefqet Xhelili (në tekstin e mëtejme: përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës), avokat nga Gjilani.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit [AC-I-21-0844] të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kolegji i Apelit të DHPGJS), të 26 janarit 2023.
3. Aktgjykimi [AC-I-21-0844] i Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së i 26 janarit 2023, i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 6 shkurt 2023.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit [AC-I-21-0844] të Kolegjit të Apelit të DHPGJS të 6 shkurtit 2023, përmes të cilit pretendohet se janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të parashtruesit të kërkesës të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, nenin 22 (Procedimi i kërkesës) dhe nenin 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji), si dhe në rregullin 25 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).
6. Më 7 korrik 2023, Rregullorja e punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës Nr. 01/2023, u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe hyri në fuqi 15 ditë pas publikimit të saj. Rrjedhimisht gjatë shqyrtimit të kërkesës, Gjykata Kushtetuese i referohet dispozitave të Rregullores së lartcekur. Lidhur me këtë, konform Rregullit 78 (Dispozitat kalimtare) të Rregullores së punës Nr. 01/2023, përjashtimisht, dispozita të caktuara të Rregullores së punës Nr. 01/2018, do të vazhdojnë të zbatohen në lëndët e regjistruara në Gjykatë përpara shfuqizimit të saj, vetëm nëse dhe për aq sa janë më të favorshme për palët.

Procedura në Gjykatë

7. Më 2 maj 2023, përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës e dorëzoi kërkesën përmes postës në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
8. Më 4 maj 2023, Gjykata pranoi kërkesën e parashtruesit të kërkesës.
9. Më 31 maj 2023, Kryetarja e Gjykatës, përmes Vendimit [Nr. GJR. KI94/23], caktoi gjyqtarin Radomir Laban gjyqtar raportues dhe përmes Vendimit [Nr. KSH. KI94/23] Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Gresa Caka-Nimani (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Safet Hoxha, anëtarë.
10. Më 21 qershor 2023, Gjykata: **(i)** e njoftoi përfaqësuesin e parashtruesit të kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ai që të plotësojë kërkesën duke bashkangjitur : a) autorizimin specifik për përfaqësimin e parashtruesit të kërkesës para Gjykatës Kushtetuese; b) Aktgjykimin [AC-I-22-0844] të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së të 26 janarit 2023; dhe c) Aktgjykimin [C-IV-14-2573] të DHPGJS-së të 8 dhjetorit 2021; si dhe **ii)** i dërgoi DHPGJS-së një kopje të kërkesës.

11. Më 5 korrik 2023, Gjykata pranoi Aktgjykimet e kërkuara, por jo edhe autorizimin specifik ashtu siç ishte përshkruar në njoftimin për regjistrim të kërkesës dhe kërkesës për dokumente shtesë.
12. Më 25 korrik 2023, Gjykata i dërgoi një shkresë parashtruesit të kërkesës, nga i cili kërkoj që të jap përgjigje Gjykatës se a është avokati Shefqet Xhelili përfaqësues i tij ligjor lidhur me kërkesën e paraqitur pranë Gjykatës.
13. Më 3 gusht 2023, Gjykata pranoi një shkresë nga parashtruesi i kërkesës, me anë të së cilës dëshmohej se avokati Shefqet Xhelili është përfaqësues ligjor i parashtruesit të kërkesës.
14. Më 14 nëntor 2023, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve të rastit

15. Nga shkresat e lëndës, Gjykata vëren se thelbi i çështjes në procedurat pranë gjykatave të rregullta ka të bëjë me kompensimin e pagave të pa paguara për periudhën nga muaji gusht të vitit 2003 deri në muajin maj të vitit 2004, në vlerën prej 1,565.41 € nga Ndërmarrja Shoqërore “Industria e Duhanit” (në tekstin e mëtejme : N.Sh “Industria e Duhanit”), në të cilën kishte punuar parashtruesi i kërkesës.
16. Më 15 gusht 2006, Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (në tekstin e mëtejme: AKM) kishte njoftuar parashtruesin e kërkesës se i'u ishte ndërprerë marrëdhënia e punës për shkakun se N.Sh “Industria e Duhanit” do t'i nënshtrohej së shpejti procedurave të likuidimit. Ky njoftim kishte bërë thirrje për të gjithë personat e interesuar, t'i parashtrojnë kërkesat e tyre kreditore pranë Autoriteti të Likuidimit për N.Sh “Industria e Duhanit”.
17. Më 4 korrik 2007, edhe zyrtarisht filloi procedura e likuidimit për N.Sh “Industria e Duhanit”, ndërsa më 21 shtator 2007, parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar kërkesën e tij pranë Autoritetit të Likuidimit të N.Sh “Industria e Duhanit” lidhur me kompensimin e pagave të pa paguara për periudhën nga muaji gusht i vitit 2003 e deri në muajin maj të vitit 2004, në shumën prej 1,565.41 €.
18. Më 10 mars 2014, Autoriteti i Likuidimit i N.Sh “Industria e Duhanit” si pjesë e Agjencisë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: AKP), përmes Vendimit GJI003-0583/0060, e kishte refuzuar kërkesën e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar me arsyetimin se e njëjta është parashkruar në bazë të nenit 36.2.1 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe nenit 608 të Ligjit për Punën e Bashkuar.
19. I pakënaqur me vendimin e lartcekur, parashtruesi i kërkesës inicioi procedurë edhe në gjykatën e rregullt, kronologjinë e së cilës Gjykata do ta paraqesë më poshtë.

Procedura në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës

20. Më 11 prill 2014, parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur një kërkesë kundër AKP-së pranë DHPGJS-së, për rishikimin e vendimit nr.GJI003-0583/0060 me të cilin i ishte refuzuar kërkesa për kompensim të shumës prej 1,565.41 euro në emër të pagave të pa paguara për periudhën kohore gusht 2003 – maj 2004 nga N.Sh “Industria e Duhanit”.

21. Më 28 shtator 2021, AKP-ja përmes përfaqësuesit të saj paraqiti mbrojtjen ndaj kërkesës së parashtruar nga parashtruesi i kërkesës, duke propozuar që të njëjten gjykata ta refuzojë si të pa pranueshme ose të pa bazuar dhe të vërtetoj vendimin e Autoritetit të Likuidimit në pajtim me nenin 74.2 të Ligjit nr.06/L-086 Për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Në këtë shkresë, AKP-ja potencon se procedura e likuidimit për N.Sh “Industria e Duhanit” kishte filluar më 4 korrik 2007, ndërsa parashtruesi i kërkesës e paraqiti kërkesën e tij më 21 shtator 2007 dhe se e njëjta u refuzua për shkak të parashkrimit konform nenit 36.2.1 të Shtojcës së Ligjit nr.04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe nenit 608 të Ligjit për Punën e Bashkuar. Tutje, e njëjta thekson se *“parashtruesi i kërkesës nuk ka parashtruar ndonjë provë pranë Autoritetit të Likuidimit se ka dorëzuar ndonjë ankesë pranë ndonjë gjykate apo organi tjetër kompetent për periudhën prej tri viteve nga dita e lindjes së kërkesës së pretenduar”*.
22. Më 8 dhjetor 2021, Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së nëpërmjet Aktgjykimit [C-IV-14-2573] e : **(i)** refuzoi si të pabazuar kërkesën e parashtruar nga parashtruesi i kërkesës; **(ii)** vërtetoi si të drejtë dhe të bazuar në ligj vendimin me shkrim me nr. GJI003-0583/0060 të 10 marsit 2014 të lëshuar nga AKP-ja ; si dhe **(iii)** vendosi që secila palë t’i bartë shpenzimet e veta procedurale.
23. Në arsyetimin e Aktgjykimit [C-IV-14-2573] të 8 dhjetorit 2021, DHPGJS-ë ndër të tjerash theksoi se :
- [...]
- “Gjykata ka shqyrtuar pretendimet dhe parashtrimet e palëve në procedurë dhe ka konstatuar se kërkesa i përket periudhës kohore nga muaji gusht 2003, deri në muajin maj 2004, ndërsa kërkesën për kompensim pranë Autoritetit të Likuidimit parashtruesi i kërkesës e ka ushtruar me datën 21.09.2007, që do të thotë se është parashtruar pas kalimit të afatit prej tri viteve nga momenti i lindjes së kërkesës. Andaj në kuptim të nenit 376 paragrafi 1 të LMD-së (1978) e cila dispozitë në mënyrë shprehimore përcakton se “kërkesa e shpërblimit të dëmit të shkaktuar parashkruhet për tri vjet nga data kur i dëmtuari ka mësuar për dëmin dhe për personin që ka bërë dëmin”, gjykata ka ardhur në përfundim se ankesa e parashtruar nga parashtruesi është e parashkruar dhe si e tillë është e pa bazuar.*
- (...) Rrjedhimisht në pajtim me dispozitën e nenit 54.1 lidhur me nenin 74 të Ligjit nr.06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet lidhur me Agjencinë Kosovare të Privatizimit u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.”*
24. Më 21 dhjetor 2021, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Kolegjin e Apelit të DHPGJS-ë kundër Aktgjykimit [C-IV-14-2573] të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-ë, i 8 dhjetorit 2021, për të gjitha bazat ankimore dhe kërkoi që : **(i)** të aprovohet ankesa si e bazuar; **(ii)** të ndryshohet Aktgjykimi i ankimuar; dhe **(iii)** të aprovohet padia si e bazuar.
25. Në këtë ankesë, parashtruesi i kërkesës pretendoi se nuk është vërtetuar në mënyrë të drejtë gjendja faktike dhe është zbatuar në mënyrë të gabuar e drejta materiale, për shkakun se njoftimi i dërguar më 15 gusht 2006 nga AKM-ja lidhur me ndërprerjen e marrëdhënies së punës, ka ndërprerë afatin e parashkrimit, prandaj Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së gabimisht ka vendosur kur ka refuzuar ankesën si të pabazuar dhe e ka vërtetuar vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit.

26. Më 26 janar 2022, AKP-ja dorëzoi përgjigjen në ankesë, me të cilën kundërshtoi pretendimet e parashtruesit të kërkesës si të pabazuara në ligj.
27. Më 26 janar 2023, Kolegji i Apelit të DHPGJS-së nëpërmjet Aktgjykimit [AC-I-21-0844] e : **(i)** refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës; **(ii)** vërtetoi Aktgjykimin [C-IV-14-2573] të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së të 8 dhjetorit 2021; dhe **(iii)** nuk caktoi taksa gjyqësore për procedurën ankimore.
28. Në arsyetimin e Aktgjykimit [AC-I-21-0844], Kolegji i Apelit të DHPGJS-së theksoi se:

“Është e qartë se paditësi ka dështuar të sjellë në gjykatë prova për të vërtetuar se ai e ka ndërprerë parashkrimin e kërkesës që ka ndodhë me datë 31 maj 2007 (...) Barra e provës në bazë të nenit 42.2 të LDHP-së dhe nenit 7 të LPK-së, bie mbi paditësin, ai ka pas interes ligjor ta mbështesë kërkesën me prova, mirëpo ai ka dështuar ta bëjë këtë.”

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

29. Përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës në kërkesën e parashtruar para Gjykatës, pretendoi se Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së dhe Kolegji i Apelit të DHPGJS-së, kanë nxjerrë aktgjykimet e kontestuara, në shkelje të të drejtave të parashtruesit të kërkesës të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës.
30. Përkitazi me pretendimin për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës thekson se *“Në rastin e palës Rexhep Ajuvazi, mendojmë se shkalla e parë dhe e dytë e DHPGJSK ka marrë aktgjykime selektive dhe diskriminuuese, pasi që në të gjitha aktgjykimet aprovuese e ka pasë për bazë të njëjtat prova materiale të cilat kanë qenë të bashkangjitura lëndës së palës Rexhep Ajuvazi”*.
31. Në këtë drejtim, përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës pretendon se në situata të ngjashme dhe me bazë juridike të njëjtë me rastet të tjera, DHPGJS ka vendosur ndryshe, ashtu që i ka aprovuar si të bazuara kërkesat e palëve, përkatësisht të ish-punëtorëve të N.Sh “Industriisë së Duhanit”.
32. Për më tepër, përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës potencon se *“Konsiderojmë se nuk qëndrojnë arsyet ligjore të paraqitura në aktgjykimin e shkallës së parë dhe të dytë, se kemi parashkrim të kërkesës në kuptim të nenit 376 paragrafi 1 të LMD-së (1978), për faktin se çështja e përmbushjes së kërkesave të punëtorëve lidhur me të drejtat e tyre në Ndërmarrjet Shoqërore që janë në administrimin e AKP-së, është e rregulluar me ligjin për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si ligj i posaçëm (lex special).”*
33. Përfundimisht, përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës kërkon nga Gjykata që: **(i)** të anulohet aktgjykimi [C-IV-14-2573] i Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së të 8 dhjetorit 2021 dhe Aktgjykimi [AC-I-21-0844] i Kolegjit të Apelit të DHPGJS i 26 janarit 2023; si dhe **(ii)** Lënda të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje në shkallën e parë të kësaj Gjykate.

Dispozitat relevante të Kushtetutës dhe Ligjit

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 31

[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1. “Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.

2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.

[...]”

Ligji mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve nr. 690 (i datës 30 mars 1978)

Neni 376

1. “Kërkesa e shpërblimit të dëmit të shkaktuar parashkruhet për tri vjet nga data kur i dëmtuari ka mësuar për dëmin dhe për personin që e ka bërë dëmin.

[...]”

Shtojca e Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit

Neni 36

Kërkesat e pavlefshme dhe jo të rregullta

1. “Autoriteti i Likuidimit refuzon, tërësisht apo pjesërisht, vlefshmërinë e Kërkesave apo interesit të pretenduar të kapitalit apo pronësisë nëse refuzimi i tillë obligohet apo lejohet sipas këtij ligji apo elementeve tjera të ligjeve të Kosovës në fuqi apo me urdhër të Gjykatës.

2. Pa kufizuar fushëveprimin apo zbatueshmërisë e paragrafit 1 më sipër, elementet në vijim përbëjnë bazë të mirë dhe të mjaftueshme sipas këtij ligji për refuzimin e një Kërkesë apo interesi të pretenduar të kapitalit apo pronësisë:

2.1. kërkesa apo pretendimi është i pasafatshëm sipas kufizimeve kohore të aplikueshme;

2.2. dokumentacioni për Kërkesën apo interesin e pretenduar i paraqitur nga kreditori i pretenduar apo bartësi i interesit të pretenduar mbetet jo i plotë edhe pas kërkesës nga kreditori i pretenduar për dokumente apo dëshmi plotësuese;

[...]”

Neni 37

Llogaritja dhe kompensimi i kërkesave

[...]”

4. Menjëherë pas Afatit për parashtrimin e kërkesave, Autoriteti i Likuidimit vlerëson vlefshmërinë, shtrirjen dhe prioritetin e kërkesave dhe pengjeve apo kolateraleve të ndërlidhura të paraqitura ndaj Ndërmarrjes dhe njofton kërkuarit në fjalë lidhur me rezultatet e atij vlerësimi; megjithatë, me kusht që:
4.1. kërkesat që konsiderohen të jenë të pasafatshme sipas afatit të kufizuar të përcaktuar me ligje të aplikueshme, si dhe kërkesat që nuk janë parashtruar në mënyrë të rregullt apo në kohë para gjykatës kompetente, refuzohen dhe nuk gëzojnë të drejtë për të marrë pjesë në disbursimet nga likuidimi; dhe

[...]

Ligji Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore

Neni 7

“7.1 Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla.

7.2 Gjykata është e autorizuar ti vërtetojë edhe faktet të cilat palët nuk i kanë paraqitur si dhe ti marrë edhe provat të cilat palët nuk i kanë propozuar, vetëm po që se nga rezultati i shqyrtimit dhe i të provuarit del përfundimi se palët kanë për qëllim disponimin me kërkesat me të cilat nuk mund të disponojnë lirisht (të përcaktuar në nenin 3 paragrafi 3 të këtij ligji), në qoftë se me ligj nuk është përcaktuar ndryshe.

7.3 Gjykata nuk mund ta bazojë vendimin e vet në faktet dhe provat lidhur me të cilat palëve nuk u është dhënë mundësia që të deklarohen.”

Ligji Nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit

Neni 42

Rregullat e përgjithshme mbi provat

[...]

2. Pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrësato apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese). Secilës palë tjetër do t'i jepet mundësia e arsyeshme për ta kontestuar legjitimitetin apo saktësinë e provave të tilla, nëpërmjet paraqitjes së parashtrësave apo provave tjera (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese) me anë të së cilave synohet përgënjeshtrimi i legjitimitetit apo saktësisë së provave të tilla. Kur prova e paraqitur nga njëra palë është në formën e dëshmisë ose dëshmisë nën betim, atëherë secila palë tjetër ka mundësinë për të marrë në pyetje personin që ka dhënë dëshminë nën betim apo që ofron një dëshmi të tillë, ose nëpërmjet dëshmisë në gjykatë, ose nëpërmjet dhënies së dëshmisë nën betim që është e xhiruar në video/audio shirit dhe që është e transkriptuar.

[...]

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

34. Gjykata, së pari shqyrton nëse janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutës dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.
35. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë se:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

36. Megjithatë, përtej kritereve të përcaktuara më lart, në vlerësimin nëse parashtruesi i kërkesës i plotëson kriteret për vlerësimin e kërkesës së tij, Gjykata rikujton nenin 48 (Saktësimi i kërkesës) të Ligjit dhe në vazhdim shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç parashihen në nenin 47, 48 dhe 49 të Ligjit, që përcaktojnë:

Neni 47
(Kërkesa individuale)

“Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

Neni 48
(Saktësimi i kërkesës)

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49
(Afatet)

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht...”

37. Sa i përket përmbushjes së kritereve të lartcekura, Gjykata vlerëson se parashtruesi i kërkesës: (i) është palë e autorizuar, në kuptim të nenit 113.7 të Kushtetutës; (ii) konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit [AC-I-21-0844] të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së të 26 janarit 2023; (iii) i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion, në kuptim të nenit 113.7 dhe nenit 47.2 të Ligjit; (iv) ka qartësuar të drejtat e garantuara me Kushtetutë, të cilat pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit; dhe (v) ka dorëzuar kërkesën brenda afatit prej katër (4) muajsh, siç përcakton neni 49 i Ligjit.
38. Përveç kësaj kritereve të lartcekura, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në paragrafin (2) të rregullit 34 (Kriteret e pranueshmërisë) të Rregullores së punës. Rregulli 34 (2) i Rregullores së punës përcakton kriteret në bazë të të cilave Gjykata mund të shqyrtoj kërkesën, duke përfshirë kriterin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Ky rregull specifikisht përcakton që:

Rregulli 34
(Kriteret e pranueshmërisë)

“(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, kur parashtruesi/ja nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij/saj.”

39. Rregulli i lartcekur, bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: GJEDNJ) dhe të Gjykatës, i mundëson kësaj të fundit, që të shpallë kërkesa të papranueshme për arsye që ndërlidhen me meritat e rastit. Më konkretisht, bazuar në këtë rregull, Gjykata mund të shpallë një kërkesë të papranueshme bazuar në dhe pas vlerësimit të meritave të saj, përkatësisht nëse e njëjta vlerëson se përmbajtja e kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin (2) të rregullit 34 të Rregullorës së punës (shih rastet e Gjykatës: [K104/21](#), parashtruese *Nexhmije Makolli*, Aktvendim për papranueshmëri, i 12 majit 2021, paragrafi 25; [K129/22](#), parashtrues *“Kosovska Banka” DD Beograd*”, Aktvendim për papranueshmëri, i 11 korrikut 2023, paragrafi 61; dhe [K122/22](#), parashtrues *Ilaz Rrahmani*, Aktvendim për papranueshmëri, i 5 korrikut 2023, paragrafi 38).
40. Në kontekst të vlerësimit të pranueshmërisë së kërkesës, duke u bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së dhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si “qartazi e pabazuar” në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, këtyre pretendimeve do të ju referohemi si “pretendime qartazi të pabazuar” dhe bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, të njëjtat kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kualifikohen si pretendime “të shkallës së katërt”; (ii) pretendime që kategorizohen me një “mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes”; (iii) pretendime “të pambështetura ose të paarsyetuara”; dhe në fund pretendime “konfuze dhe të paqarta” (shih, ndër të tjerash rastet e GJEDNJ-së *Kemmachev kundër Francës*, kërkesa nr.17621/91, kategoria (i); *Mentzen kundër Letonisë*, kërkesa nr. 71074/01, kategoria (ii) dhe *Trofimchuk kundër Ukrainës*, kërkesa nr. 4241/03, kategoria (iii)).
41. Gjykata, gjatë vlerësimit të pranueshmërisë së kërkesës, përkatësisht, gjatë vlerësimit nëse kërkesa e parashtruesit është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, do të rikujtojë thelbin e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtruesit të kërkesës. Në vlerësimin e pretendimeve të tilla, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, nen, i cili e detyron Gjykatën të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të Kushtetutës në harmoni me vendimet gjyqësore të GJEDNJ-së.
42. Në rastin konkret, Gjykata rikujton se esenca e kësaj çështje ndërlidhet me procedurën gjyqësore që u zhvillua pranë DHPGJS-së në të dyja shkallët, në të cilën parashtruesi i kërkesës kërkoi që të realizonte të drejtën për pagat e pa paguara në shumën prej 1,565.41 € për periudhën kohore nga muaji gusht 2003 e deri në muajin maj 2004 nga N.Sh “Industria e Duhanit”. Lidhur me këtë, Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së dhe Kolegji i Apelit i DHPGJS-së e kishin refuzuar kërkesën e tillë, duke e vlerësuar se e njëjta ishte e pabazuar, meqenëse sipas ligjit në fuqi në atë kohë, kërkesa e parashtruesit të kërkesës ishte parashkruar pasi kishin kaluar tri (3) vite që nga dita kur kishte filluar të rrjedhë afati për realizimin e të drejtës së tij.
43. Sa më sipër, parashtruesi i kërkesës thekson se pikërisht përmes dy vendimeve të shkallës së I-rë dhe të II-të të DHPGJS-së ka ardhur deri tek shkelja e të drejtave të tij kushtetuese të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës si pretendim kryesor ka “në rastin e palës *Rexhep Ajvazi*, mendojmë se shkalla e parë dhe e dytë e DHPGJSK ka marrë aktgjykime selektive dhe diskriminuese, pasi që në të gjitha aktgjykimet aprovuese e ka pasë për bazë të njëjtat prova materiale të cilat kanë qenë të bashkangjitura lëndës së palës *Rexhep Ajvazi*”.

44. Gjykata, para se të analizojë pretendimin e parashtruesit të kërkesës, vëren se parashtruesi i kërkesës e ndërlidh pretendimin e tij për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës me procedurën e vendimmarrjes si në Kolegjin e Specializuar të DHPGJS-së në shkallë të parë, ashtu edhe në Kolegjin e Apelit të DHPGJS-së në shkallë të dytë, që në kuptimin thelbësor i imponon Gjykatës detyrimin që të dy vendimet “*t’i shqyrtojë në tërësinë e tyre*” në kontekst të shkeljeve të pretendura të nenit 31 të Kushtetutës, gjë që është në përputhje me praktikën e GjEDNj-së, e cila thotë se është “*detyrë e Gjykatës që të shqyrtojë procedurat në tërësi, që në rastin konkret përfshin të gjitha vendimet e gjykatave të rregullta në një procedurë të vetme*”(shih, ndër të tjerash, Aktgjykimin e GjEDNj-së në rastin e *Helmerts kundër Suedisë*, të 29 tetorit 1991, kërkesa nr. 11826/85, Seria A nr. 212, f. 15, paragrafi 31).
45. Në rastin konkret, thelbi i ankimit të parashtruesit të kërkesës qëndron në faktin se i njëjti pretendon se kërkesa e tij për kompensimin e pagave të pa paguara për periudhën nga muaji gusht 2003 deri në muajin maj 2004 nga N.Sh “Industria e Duhanit”, nuk ishte parashkruar në bazë të ligjit në fuqi në atë kohë, pasi që Njoftimi i AKM-së për ndërprerje të marrëdhënies së punës të 15 gushtit 2006 e kishte ndërprerë afatin e parashkrimit dhe rrjedhimisht pretendon se pikërisht ky njoftim e kishte rifilluar sërish afatin e parashkrimit për kërkesën e tij.
46. Në këtë drejtim, Gjykata konstaton se të gjitha vendimet e DHPGJS-së ofruan arsyetime përkatëse lidhur me refuzimin e ankesës së parashtruesit të kërkesës, duke konstatuar se “*parashtruesi i kërkesës kishte dështuar të ofrojë dëshmi që vërtetojnë se i njëjti ka ndërprerë parashkrimin e kërkesës së tij*”.
47. Për më tepër, nga shkresat e lëndës, Gjykata konkludoi se më 8 tetor 2021, Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së i kishte dërguar një shkresë parashtruesit të kërkesës, nga i cili kishte kërkuar për të ofruar prova të reja që nuk janë në shkresat e lëndës për të mbështetur kërkesën e tij për pagat e pa paguara me paralajmërimin që “[...] nëse i njëjti nuk ofron ndonjë provë të re, vendimi do të bazohet në provat ekzistuese.”
48. Sa më sipër, parashtruesi i kërkesës kishte dorëzuar në DHPGJS vetëm Njoftimin për përfaqësimin e punëtorëve të N.Sh “Industria e Duhanit” në Gjilan, e që për Kolegjin e Specializuar të DHPGJS-së nuk përbënte ndonjë provë e cila do të ndikonte që kjo e fundit të vendoste ndryshe lidhur me ankesën e parashtruesit.
49. Gjykata, më tej gjen se edhe Kolegji i Apelit të DHPGJS ishte pajtuar me konstatimet e Autoriteti të Likuidimit pranë AKP-së dhe Kolegjit të Specializuar të DHPGJS -së se kërkesa për pagat e pa paguara është parashkruar, duke konkluduar se bazuar në barrën e provës që e parasheh neni 42.2 i Ligjit për DHPGJS dhe neni 7 i Ligjit për Procedurën Kontestimore, parashtruesi i kërkesës ka dështuar të mbështesë kërkesën e tij me provat konkrete.
50. Gjykata, vëren se Autoriteti Kompetent i Likuidimit të AKP-së, së bashku me Kolegjin e Specializuar të DHPGJS-së -së dhe Kolegjin e Apelit të DHPGJS-së -së kanë vepruar në atë mënyrë që mundësuan brenda kornizës procedurale për të pranuar dhe për të hyrë në shqyrtimin e meritave të kërkesës, por vetë fakti se parashtruesi i kërkesës nuk paraqiti provat e kërkuara për të justifikuar ndërprerjen e afatit të parashkrimit apo të bazojë kërkesën e tij, rezultoi me përfundimin se kërkesa e tij është parashkruar.
51. Në dritën e fakteve të mësipërme, Gjykata e konsideron të nevojshme të vë në pah se parashtruesit të kërkesës i është mundësuar zhvillimi i procedurës bazuar në parimin e kontradiktoritetit, pasi që i njëjti ka mundur që gjatë fazave të ndryshme të procedurës të paraqet provat e kërkuara nga Autoriteti i Likuidimit dhe nga Kolegji i Specializuar i DHPGJS -së, e mbi të gjitha edhe nga Kolegji i Apelit të DHPGJS -së

lidhur me pretendimin e tij për ndërprerje të parashkrimit të së drejtës së tij për të kërkuar kompensimin e pagave të pa paguara nga N.Sh “Industria e Duhanit”. Në këndvështrimin objektiv, Autoriteti i Likuidimit dhe Kolegji i Specializuar i DHPGJS - së, por edhe Kolegji i Apelit të DHPGJS i kanë dëgjuar dhe shqyrtuar në mënyrë të rregullt argumentet që ishin relevante për zgjidhjen e rastit, andaj dështimi që të ofrojë prova mbi të cilat do të bazohej kërkesa e tij e paraqitur pranë Autoritetit të Likuidimit, bie mbi supet e parashtruesit të kërkesës.

52. Gjykata rikujton se në lidhje vlerësimin e pretendimeve “të shkallës së katërt” e që ndërlidhen me shkelje të pretenduara të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, ajo vazhdimisht ka theksuar se “drejtësia” e kërkuar nga nenet e lartpërmendura nuk është drejtësi “*substanciale*”, por drejtësi “*procedurale*”. Ky koncept, kryesisht në aspektin praktik, në parim, nënkupton: (i) mundësinë e zhvillimit të procedurave sipas parimit të kontradiktoritetit; (ii) mundësinë e palëve që në faza të ndryshme të kësaj procedure, të paraqesin argumente dhe dëshmi që i konsiderojnë të rëndësishme për rastin përkatës; (iii) mundësinë e kontestimit efikas të argumenteve dhe dëshmive të paraqitura nga pala kundërshtarë; dhe (iv) të drejtën që argumentet e tyre të cilat, shikuar në mënyrë objektive, janë të rëndësishme për zgjidhjen e rastit, të dëgjohen dhe shqyrtohen nga gjykatat e rregullta në mënyrën e duhur; dhe për pasojë, procedura, marrë në tërësi, do të rezultonte si e drejtë. Për më tepër, vlerësimi i drejtësisë në një procedurë në tërësinë e saj, është një ndër premisat kryesore të praktikës gjyqësore të Gjykatës dhe asaj të GJEDNJ-së (shih, në këtë kontekst, rastin e GJEDNJ-së *Barbera, Messeque dhe Jabardo kundër Spanjës*, nr.10588/83, 10589/83, 10590/83, Aktgjykim i 6 dhjetorit 1988, paragrafi 68; dhe rastin e Gjykatës *KI22/19*, parashtrues i kërkesës *Sabit Ilazi*, Aktvendim për papranueshmëri i 7 qershorit 2019, paragrafi 42).
53. Gjykata, vlerëson se në rastin e parashtruesit të kërkesës janë respektuar të gjitha kriteret e lartcekura nga ana e gjykatave të rregullta dhe se pakënaqësia e parashtruesit të kërkesës me rezultatin e procedurës nga gjykatat e rregullta nuk mund vetvetiu të ngrejë pretendim të argumentueshëm për shkeljen e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë (shih rastin e GJEDNJ-së, *Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, nr. 5503/02, Aktgjykim i 26 korrikut 2005, paragrafi 21).
54. Si përfundim, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk ka argumentuar me ndonjë provë konkrete pretendimet e tij për shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut të garantuara me Kushtetutë, sepse pretendimet e paraqitura nga ai në asnjë mënyrë nuk tregojnë që gjykatat e rregullta i kanë mohuar atij të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës.

Përfundim

55. Bazuar sa më sipër, Gjykata konstaton se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të të drejtave të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës janë pretendime që kualifikohen si pretendime “*të pambështetura ose të paarsyetuara*”. Rrjedhimisht, kërkesa në tërësi deklarohet si qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 34 të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit dhe rregullat 34 (2) dhe (3) dhe 48 (1) (b) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 14 nëntor 2023, njëzëri

VENDOS

- I. TË REFUZOJË kërkesën;
- II. T'UA KUMTOJË këtë aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues


Radomir Laban

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese




Gresa Caka-Nimani